



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Autoriteti i Konkurrencës  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority  
Nr. i Prot./Br.Prot./Prot.No. 746/24-12/D  
Nr. i Fq./Br.St./No.Pg. 1/3  
Data/Datum/Date: 25.11.2024  
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Vendimi Nr.101/24

Prishtinë, më 25.11.2024

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 26, nenit 27, nenit 29, nenit 35, nenit 36 paragrafi 6 neni 39 si dhe neni 55 paragrafi 2 me nën paragrafin 2.4 i Ligjit për Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, bazuar në propozim/kërkesën nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.11.2024 merr këtë:

### KONKLUZION

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, konkludon se nuk është kompetent për të shqyrtuar ankesën e Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë, sipas Ligjit Nr.08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 55 paragrafi 2, nën paragrafi 2.6.

### A r s y e t i m

#### Inciativa për fillimin e procedurës

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datë 30.08.2024 ka pranuar një kërkesë/propozim nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, lidhur me punën e Auditorëve të Energjisë.

Pas përfundimit të procedurave nga Thirrja e parë publike, Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë ka shpallur Thirrjen e dytë Publike për zbatimin e projektit Emergjent “ZBATIMI I MASAVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË PËR SHTËPITË INDIVIDUALE TË BANIMIT” me qëllim të përmirësimit të kursimit të energjisë dhe rritjes së mirëqenies në shtëpitë individuale.

Sipas kërkesës së palës, gjatë procedurës së zbatimit të projektit emergjent aplikantët kane hasur në disa parregullsi, lidhur me tarifën e çmimit të Auditorëve të Energjisë për vlerësimin e shtëpive.

Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 30, neni 35 par.1, neni 39, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka autorizuar grupin e punës, të siguroj të dhënat e nevojshme për shqyrtimin paraprak lidhur me rastin në fjalë.

*U.P.B.*

*F.H.*

*SGK*

## **Pretendimet e palës ankuese**

Sipas palës ankuese, gjatë zbatimit të projektit emergjent aplikantët kane hasur në disa parregullsi sa i përket tarifës së paraparë – 150€ për Auditorët e Energjisë. Ky është çmimi maksimal dhe i kufizuar që FKEE do të paguaj në emër të auditimit të energjisë, por sipas informatave që ka pranuar FKEE nga disa aplikant, ky çmim ka lëvizur deri në 400.00€ - 500.00€, ku Auditorët u kërkojnë aplikantëve para shtesë pa qenë të autorizuar nga FKEE.

Ankesa është të shikohet nëse ofertuesit e shërbimeve (Auditorët e Energjisë), të cilët figurojnë në listën e certifikuar nga Ministria e Ekonomisë, mund të kenë sjellje anti-konkurruese përmes, shkëmbimit të informacionit apo praktikë bashkërenduese për çmime.

## **Vlerësimi, analizimi i të gjeturave dhe rekomandimet përkatëse gjatë shqyrtimit paraprak**

Autoriteti i Konkurrencës zhvillimin e procedurës e bazon në nenin 35 – Propozimi për Fillimin i Procedurës dhe ex-officio (sipas detyrës zyrtare) nenin 36 - Fillimi i Procedurës, dhe atë në rastet kur kemi të bëjmë me të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ana e ndërmarrjeve që operojnë në tregjet përkatëse.

Grupi i punës pas shqyrtimit të ankesës lidhur me dyshimin e FKEE për punën e Auditorëve *se mund të ketë ndonjë sjellje anti-konkurruese përmes, shkëmbim informacioni apo praktikë bashkërenduese për çmime*, të cilët përveç shumës 150.00 € (tarifë e cila duhet të paguhet përmes transaksionit bankar në mënyrë që të mbetet si dëshmi që të rimburohet nga FKEE), Auditorët kanë kërkuar 150.00 deri në 400.00 € shtesë (para në dorë), për arsye se “kjo punë duhet të paguhet më shumë, apo për shkak të distancës “etj.

Bazuar në Analizën e Konkurrencës, lidhur me tregun e Auditorëve të Energjisë, si dhe Rregullores (MEPTINIS) Nr. 05/2020 për Sistemin e Ofruesve të Shërbimit Energjetik dhe Kriteret Minimale për Auditimin Energjetik, Auditorët të cilët janë përzgjedhur për të bërë vlerësimin e shtëpive nëpër qytetet e Kosovës, janë certifikuar nga Ministria e Ekonomisë, fillimisht duke u trajnuar nga Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri në bazë të kësaj rregullore, përkastësisht neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3., i cili përkufizon se Auditor i Energjisë – është personi fizik apo juridik i licencuar për kryerjen e auditimeve të energjisë në pajtim me këtë rregullore për procedurën e përzgjedhjes së Auditorëve dhe rregulloren e cila është aplikuar, si dhe neni 17 Kodi i Mirësjelljes për Auditorët e Energjisë bazuar në paragrafin 7. Certifikata e Auditorit të Energjisë mund të pezullohet kur vepron në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes dhe të anulohet nga AKEE si në rastet e mëposhtme: Dorëzimi i provave të rreme për certifikim; Certifikata e Auditorit të Energjisë përdoret nga persona të paautorizuar; Auditori i Energjisë dorëzon një auditim të energjisë pa kryer auditimin; Auditori i Energjisë dorëzon një auditim të energjisë që nuk plotëson kërkesat e nenit 22 të kësaj Rregullore.

Zbatimi i ligjit të konkurrencës, në sektorët e rregulluar me ligje të veçanta varet edhe nga statusi apo veprimtaria të cilën e ushtrojnë palët. Duke marrë parasysh se Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuptim të nenit 3, paragrafi 10, “Ndërmarrje”- çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, i angazhuar në veprimtari ekonomike, pavarësisht statusit juridik dhe mënyrës së financimit.

Në këtë rast, veprimtarinë të cilën e ushtrojnë Auditorët për vlerësimin e shtëpive të aplikantëve, nuk e mbulon Ligji Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi që Auditorët e certifikuar nga Ministria e Ekonomisë operojnë si individ, dhe jo si biznese apo ndërmarrje, e që në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, çështje parësore është monitorimi i sjelljeve të ndërmarrjeve në tregun përkatës.

*U.B.*

*F.M.*

*SGK*

Duke pasur parasysh vlerësimin e ligjshmërisë së sjelljeve të Auditorëve të Energjisë, Autoriteti konsideron se sipas Ligjit nr. 06/L-079 për Eficiencë të Energjisë si dhe Rregullores (MEPTINIS) Nr. 05/2020 për Sistemin e Ofruesve të Shërbimit Energjetik dhe Kriteret Minimale për Auditimin Energjetik, nuk është kompetent për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të veçanta, të cilat rregullojnë veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve në këtë sektor.

Andaj, nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, duke u bazuar në Ligjin Nr.08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 55 paragrafi 2, nën paragrafi 2.6 vendosi si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

Ky konkluzion, hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga ana Komisionit.

**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**Komisioni**

**Neime Binaku - Isufi**  
Kryetare



**Kaltrina Sela**  
Nënkryetare

**Nafije Osdautaj**  
Anëtare

**Florent Mehmeti**  
Anëtar

**Salihe Gashi- Loku**  
Anëtare

\_\_\_\_\_

**Këshilla juridike:** Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.

Me këtë KONKLUZION të njoftohen:

- Palë/ndërmarrjet në monitorim/shqyrtim paraprak
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arkiva